



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI



Mes

Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Shqipëri

Dhe

**Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionisteve të tjerë Shëndetsor të Kosovës
(OIK)**

Duke u njohur me rëndësinë e shkëmbimeve në fushat e shkencave mjekësore teknike, po ashtu edhe mundësitë e siguruar nga forcimi i kontakteve mes anëtarëve të institucioneve, **Universiteti i Shkodrës dhe Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionisteve të tjerë Shëndetsor të Kosovës (OIK)** nënshkruajnë marrëveshjen e mëposhtme në fushën e bashkëpunimit akademik.

Neni 1

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është inkurajimi i shkëmbimeve mes **Universitetit të Shkodrës dhe Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionisteve të tjerë Shëndetsor të Kosovës (OIK)** në të gjitha fushat prezente që lidhen me shkencat mjekësore teknike.

Neni 2

Bashkëpunimi mes dy institucioneve respektive duhet të nxisë aktivitetet e mëposhtme:

- Shkëmbime dhe bashkëpunime reciproke të specialistëve të fushave mjekësore teknike;
- Organizimi i aktiviteteve, seminareve, dhe formave të tjera shkëmbimi njohurish nga palët;
- Shkëmbim literature, teksteve dhe publikimeve;
- Realizimi i projekteve të përbashkëta;
- Shkëmbime eksperiencash në realizimin e praktikave profesionale, realizimin e aktiviteteve të çertifikuara, realizimin e konferencave ndërkombëtare dhe të rajoneve shqipfolëse;
- Shkëmbim stafi administrativ me qëllim përfitim eksperience;

- Si dhe forma të tjera bashkëpunimi me qëllim që të jenë reciprokisht përfituese për të dyja palët që i referohet shkencave mjekësore teknike.

Neni 3

Të gjitha aktivitetet e përmendura në Nenin 2 do të bazohen mbi reciprocitet.

Neni 4

Të dy Institucionet të paktën një herë në vit do bien dakort mbi format dhe fushat konkrete të bashkëpunimit. Këto programe të përbashkëta mund të ndryshohen dhe të amendësohen nga një marrëveshje e shkruar dhe e firmosur nga të dyja palët.

Neni 5

Aktivitetet e përbashkëta do të rishikohen çdo vit.

Neni 6

Marrëveshja prezente nënshkruhet si një marrëveshje e vazhdueshme pa limite kohore.

Neni 7

Marrëveshja hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 8

Secili Institucion ka të drejtë të propozojë aneksimet dhe ndryshimet të dokumentit në formë të shkruar dhe ndryshimet do fillojnë pas përshtatjes së tyre nga palët.

Neni 9

Secili Institucion ka të drejtë të ndërpresë marrëveshjen prezente duke paraqitur një lajmërim me shkrim të paktën gjashtë muaj para afatit.

Neni 10

Aktivitetet që nuk janë përfshirë në këtë Marrëveshje do akordohen nga palët, të cilat do vazhdojnë të kenë kontakte, vullnetin e mirë, fleksibilitetin dhe cilësinë e adaptueshme për realizimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 11

Kjo Marrëveshje do paraqitet në dy kopje identike në gjuhën shqipe. Secili Institucion do marrë nje kopje.

Prof. dr. Adem Bekteshi

**Rektori
Universiteti i Shkodrës**



W=979 Prot.

Ma. Bsc. Naser Rrustemaj



**Kryetari
Oda e Infermierëve,
Mamive dhe Profesionisteve të tjerë
Shëndetsor të Kosovës (OIK)**

Shkodër me __.03.2019